

# REVISTA “KASTRIOTI”



Ishte një natë e ftohtë dimri. Ku çdokush rrinte i mbyllur në shtëpi. Stuhia e madhe e borës ishte si një ferr për të varfërit të cilit jetonin nëpër kasolle...

Në këtë fshat jetonte edhe një fshatar i varfër me familjen e tij: bashkeshortja dhe fëmijët


*vulgari Albanico. Vnt' paghezonte premenie Aric et birit et sperite senie. C'q. si quis hoc modo baptizatus fuerit iterum non rebaptizetur sed suppletur orationes et qd' d'missum est. Verum si dubietur. An uerba illa prolata fuerint a laico uel femina, que' forte sic baptizauerit licet sacerdos baptizans mittat aquam in puerum, dicendo si tu es baptizatus ego non te rebaptizo, sed si non es baptizatus ego te baptizo in n'ie Patris et filij et spiritus sancti...*

*Item mandamus q. in qualibet Ecclesia in qua exerceatur cura animarum, fiat fons usq. ad Sabbatum sanctum proxime futurum sub pena Iperperuinquagz et si erit Contrafactum totiens cadae in dictam penam, quotiens quindecim dies exinde decurrerint quousq. fons factus erit.*

*Cum Confirmatio Crismatis sit vnu ex septē Sacramentis Ecclesie, necessarium, et non nisi per Pontificem conferri possit, reperimusq. ocs ut plurimum non Crismatos pbrz Ignorantia... afferentium illos Crismatos quando per presbiterum*



Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, ku futen gjuhët indoiranike, greqishtja, gjuhët romane, gjuhët sllave, gjuhët gjermane, etj. Ajo formon një degë të veçantë në këtë familje gjuhësore dhe nuk ka ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjërën prej gjuhëve të sotme indoevropiane. Karakteri



Delegatë të Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

## **Parathënie**

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, ku futen gjuhët indo-iranike, greqishtja, gjuhët romane, gjuhët sllave, gjuhët gjermane, etj. Ajo formon një degë të veçantë në këtë familje gjuhësore dhe nuk ka ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjërën prej gjuhëve të sotme indoevropiane. Karakteri indoevropian i shqipes, përkatësia e saj në familjen gjuhësore indoevropiane, u arrit të përcaktohej e të vërtetohej që nga mesi i shekullit XIX, në sajë të studimeve të gjuhësisë historike krahasuese.

Në shekullin e II-të të erës sonë gjeografi Ptolomeu në Aleksandri të Egjiptit në hartën e tij botërore përmend për here të pare fisin **Albanói** me qytetin **Albanópilos**, midis Durrësit dhe Dibrës. Nga ky emër fisi populli shqipëtar e ka trashëguar emrin Albano nose Arbanon prej nga vjen edhe forma popullore Arbëresh dhe Arbënesh.

Emri i ri në litetaturë del për të shënuar gjuhën te Buzuku, më 1555 **“qi vjen me thashun shqip”**, Pjetër Budi 1621 **“shqip të na e thotë”**. Pra emir shqip lidhet me gjuhë dhe jo me emrin e shpendit shqipe-shqiponjë. Siç thekson edhe gjuhëtari ynë i shquar Eqrem Çabej.

Shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV. Dokumentet e para të gjuhës shqipe janë:

-**“Formula e pagëzimit”, “Fjalorthi”** i Arnold von Harff-it, **“Perikopeja e ungjillit”**.

Por vepra e parë e shkruar në shqip, për sa dihet deri më sot, është **“Meshari”** i Gjon Buzukut, i vitit 1555. Vepra e dytë është **“e Mësueme e krishterë”** e Lekë Matrëngës.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, dialektin e veriut ose gegërishten dhe dialektin e jugut ose toskërishten.

**Kongresin e Manastirit** thirrret tubimi i dijetarve shqiptarë më 14 nëntor - 22 nëntor 1908 në Manastir, për përcaktimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Në këtë kongres ishin të pranishëm 150 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Mithat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: Liria dhe Dituria. Sekretare e komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë. Nënkretar u zgjodh Grigori Cilka, nga Korça si dhe 11 anëtarë të tjerë.

**Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe** u hap në Tiranë më 20 nëntor të vitit 1972. Aty morën pjesë 87 delegatë nga Shqipëria dhe nga shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, si dhe nga arbëreshët e Italisë. Qëllimi i Kongresit ishte të përcaktonte parimet dhe drejtimet kryesore të hartimit të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar.

Shqipja flitet sot nga më se gjashtë milionë vetë në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Serbisë jugore, si dhe në viset e Çamerisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe në shqiptarë të mërguar në viset e ndryshme të botës para Luftës së Dytë Botërore dhe në këtë dhjetëvjeçar in e fundit.

**BLERINA ZENDELI**

# ORIGJINA E GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indeovrpiane, në të cilën përfshihen këto degë gjuhësore: indishtje, iranishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, gjuhët gjermane etj.

Shqipja si gjuhë indeovriopjane është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Nga ilirishtja nuk kemi dokumente të shkruara, por kemi disa fjalë që na bën të kuptojmë se gj. Shqipe ka ekzistuar si p.sh: sika-thika, peli-pleq, si dhe disa emra gjeografik Skodra-Shkodra, Dyrrahu-Durrsi etj. Shqipëria në fillim e ka pasur emrin ALBANON nga gjeografi i njohur Ptolomeu që në Aleksandri të Egjiptit në hartën etij botërore përmend për herë të parë fisin Albanio.

Emri i ri në literatur del për të shënuar gjuhën te Buzuku më 155 qi vjen me thashun shqip, Pjetër Budi (1621) shqip të na e thotë. Pra emri shqip lidhet me gjuhën dhe jo me emrin e shpendit shqipe- shqipojnë, siç thekson edhe gjuhëtari ynë i shquar EQREM CABEJ.

Problemi i origjinës së gjuhës shqipe është një nga problemet shumë të debatuar të shkencës gjuhësore. Ajo e ka burimin, pa dyshim, prej njerës nga gjuhët e lashta të Gadishullit të Ballkanit, ilirishtes ose trakishtes. Në literaturën gjuhësore qarkullojnë dy teza themelore për origjinën e shqipes: teza e origjinës ilire dhe teza e origjinës traka. Teza ilire ka gjetur mbështetje më të gjerë historike dhe gjuhësore. Ajo është formuar që në shekullin XVIII në rrethet e historianëve.

Përpykjen e parë shkencore për të shpjeguar origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, e bëri historiani suedez Hans Erich Thunmann në veprën e tij "Undersuchunger liber di Geschichte der Östlichen europäischen Völker" Leipzig 1774. Ai, duke u mbështetur në burime historike latine e bizantine dhe në të dhëna gjuhësore e onomastike, arriti në përfundimin se shqiptarët janë vazhduesit autoktonë të popullsisë së lashtë ilire, e cila nuk u romanizua siç ndodhi me popullsinë trako-dake, paraardhëse të rumunëve.

Tezea e origjinës ilire të shqiptarëve është

mbështetur nga albanologu i mirënjohur austriak Johannes Georges von Hahn në veprën e tij Albanesische Studien, publikuar më 1854

Që nga ajo kohë deri në ditët tona, një varg dijetarësh të shquar historianë, arkeologë e gjuhëtarë, kanë sjellë duke plotësuar njeri tjetrin, një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore, që mbështesin tezën e origjinës dhe të shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga keto argumente themelore, janë:

1. Shqiptarët banojnë sot në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar fise ilire; nga ana tjetër në burimet historike nuk njihet ndonjë emigrim i shqiptarëve nga vise të tjera për t'u vendosur në trojet e sotme.

2. Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra sendesh, fisesh, emra njerëzish, glosa, etj., që janë njohur si ilire, gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.

3. Format e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krahasuara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë zhvilluar sipas rregullave të fonetikës historike të shqipes, dmth kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.

4. Marrëdhëniet e shqipes me greqishtjen e vjetër dhe me latinishten, tregojnë se shqipja është formuar dhe është zhvilluar në fqinjësi me këto dy gjuhë këtu në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.

5. Të dhënat arkeologjike dhe ato të kulturës materiale e shpirtërore, dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë te shqiptarët e sotëm.


Nga të gjithë këto argumente, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur, rezulton se teza e origjinës ilire e gjuhës shqipe, është teza më e mbështetur nga ana historike dhe gjuhësore.

# DOKUMENTET E PARA TË GJUHËS

Dokumentet e para të gjuhës shqipe janë:

1. **Formula e Pagëzimit**
2. **Fjalori i Arnold Von Harfit**
3. **Perikopeja e Ungjillit të Pashkës**

Nën pluhurin e arkivave të Evropës dhe sidomos të atyre të Vatikanit mund të gjenden edhe shumë dokumente të tjera, ndoshta më të plotë e më domethënës.



## 1. Formula e Pagëzimit (1462)

Më i vjetri ndër këto tri dokumente është "Formula e pagëzimit" Ajo i përket vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në mes të një shkrimi latinisht. Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli, mik e bashkëpunëtor i Skënderbeut (1417-1469), gjatë një vizite në dioqezën e tij gjeti shumë të meta e mangësi në punët e ushtrimit të fesë. Për t'i shmanhur ato ai lëshoi një qarkore në gjuhen latine. Kjo qarkore është lëshuar nga një kishë në Mat dhe mban datën 8 nëntor 1462. Me anë të saj, ndërmjet të tjerash, ai jepte leje që, në ato kohë luftërash kur prindërit nuk kishin mundësi t'i dërgonin fëmijët në kishë t'i pagëzonin vetë në shtëpi, duke

thënë shqip në këtë ceremoni " Formulën e pagëzimit" që është: **"Un të pagëzonj pr'emen't Atit e t'birit e t'shpirtit shenjt".** Formula është shkruar në dialektin e veriut me shkronja latine. Dokumenti u zbuluar me 1915 nga historiani rumun Nikola Jorga në një nga bibliotekat e Milanos, Itali.

## 2. Fjalori i Arnold Fon Harfit (1497)

Item	bojiko	broyt	fjet	slaeffen
vene	wijn	wasser	nircoestrasse	golden morgen
15 mische	fleysch	keuse	meretzewen	guden daich
jat	keuse	ake	ja kasee zat ve	wat halstu
foetje	eyer	dat	mir beucht	
oitter	essich	kess	felgen gyo kalfs	wat gylt dat
poyle	eyn henne	do dapij	ich wyl it golden	
20 pykko	vyssche	haf	no kammiss	wessche mir
krup	sals	nijn	hempt	
myr	goyt	no	kaffs,	wie heyscht dat
kyckgo	buesse		Tzellen,	
meqarune	essen	nea		eyn
25 pijse	drincken	dna		trawy
taurme	eyn wirlings	trij		drjij
geneyre	eyn maan	quater		vier
growsa	eyn frauwe	passa		vunff
denarye	wijgelt	just		sees
30 ato	ja	statte		seuen
jae	noyn	tette		acht
criste	got	nante		nuyne
dreok	dos dmal	diese		tzien
kijrij	eyn kertz	nijgent		hundert
35 kale	eyn pert	nemijgo		dusent
albe	lauer			

Me të njëjtin alfabet latin është shkruar në shekullin e XV edhe dokumenti i dytë i gjuhës shqipe: Fjalorthi i Arnold fon Harfit, i vitit 1497. Udhëtari gjerman Arnold Fon Harf (1417-1505) ne vitin 1496, u nis nga Kelni, për të bërë një vizitë në tokat e shenjtja, në Palestinë, udhëtimi që e kreu për tre vjet. Në vitin 1497 ai kaloi në bregdetin e Shqipërisë dhe konkretisht në Ulqin, Durrës e Sazan. Gjatë këtij udhëtimi për të komunikuar sadopak me njerëzit, ai shënoi 26 fjalë shqipë, 8 shprehje e numrat 1 deri 10 dhe 100 e 1000 të shoqëruar me përkthim në gjermanisht. Janë fjalë të zakonshme si: ujë, verë, bukë, mish etj., që iu deshën udhëtarit në jetën e tij të përditshme sa qëndroi ne Shqipëri. Me përshtypjet e udhëtimit Harfi la në gjermanisht një dorëshkrim, i cili u botua më 1860, pas tre shekujsh e gjysmë. Këtu gjendet edhe ky Fjalorth i vogël i gjuhës shqipe, i cili përbën dokumentin e dytë të

shqipes së shkruar. Ndër të tjera ai shkruan se "Ulqini është një qytet shqiptar i bukur e i vogël". Për Shkodrën megjithëse kaloi nëpër të, ngaqë udhëtimi Ulqin-Durrës, e bëri me det, thotë "se është një qytet i madh i sapo pushtuar nga osmanët". Ishullin e Sazanit e përshekruan "si një liman të mirë deti, ku ka shume anije, në krahun e majtë të të cilit ndodhet një fshat i madh me 2000 vatra, i quajtur Vlorë" etj.

## 3. Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh.XV-fillimi sh.XVI)

Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh.XV-fillimi sh.XVI) është dokumenti i tretë i shqipes së shkruar

Ai i perket fundit të shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI. Ky dokument përbëhet nga 2 pjesë të vogla bible në gjuhën shqipe që u gjetën në një dorëshkrim greqisht të shekullit të XIV, me të cilin ato nuk kanë asnjë lidhje. Ato janë në dialektin e Jugut, të shkruara me alfabetin grek. Këto fakte tregojnë se gjuha shqipe në atë kohë duhet të ketë qenë shkruar jo vetëm në Shqipërinë e Veriut, por edhe në Shqipërinë e Jugut.

**"Meshari" i Gjon Buzukut**, botuar prej tij më 1555, mbahet deri më sot, si e para vepër e shqipes së shkruar. Niveli i përpunuar i gjuhës dhe ortografia e stabilizuar duhet të jetë rezultat i një tradite më të hershme të shkrimit të shqipes, traditë që nuk njihet.

**PEME BALLAZHI**

# KONGRESI I MANASTIRIT


**Kongresin e Manastirit** thirret tubimi i dijetarve shqiptarë më 14 nëntor - 22 nëntor 1908 në Manastir, për përcaktimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Gjatë zhvillimit të letrave shqipe u hartuan disa alfabetet të ndryshme. Një nga

zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë. Nënkrjetar u zgjodh Grigori Cilka, nga Korça si dhe 11 anëtarë të tjerë. Në atë Kongres merrnin pjesë shqiptare të fesë myslimane, katolike, ortodoksë, protestantë, njerëz të ditur dhe të gjithë erdhën së bashku, për arritjen e një qëllimi të madh kombëtar. Kërkesa e kombëtaristëve shqiptarë ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me alfabetin latin, gjë që nënkupton mosnënshtrimin qoftë ndaj otomanëve, qoftë ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lënë mënjanë alfabetin e Stambollit, dhe ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me alfabetin latin me 36 shkronja dhe që përdoret deri më ditët tona. Gjithashtu, u vendos që pas dy vjetësh të mbahej një Kongres i dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrirjen e dialekteve gegë dhe toskë në një gjuhë të njëzuar shqipe. Në Manastir u hap dhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Bashkimi i Kombit si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore. Edhe në këtë luftë, shkolla shqipe doli

fitimtare. Me pak mjete dhe mësues, por me dëshirën në shpirt për dituri shkollore shqiptare, midis pengimeve, nga armiqtë e afërm dhe të largët, shkolla shqipe fitoi nga veriu e deri në jug të Shqipërisë dhe përgatiti breza të rinj atdhedashës. Shqiptarët trima si Isa Boletini dhe burri i zoti Ismail Bej Qemal Vlora, do nxitonin hapat për të shpallur mëvetësinë e Shqipërisë më 28 nëntor të 1912 në Vlorë. Pas pak muajsh filloi Lufta Ballkanike dhe Manastiri e Shkupi, dy qytete historikisht të banu-



më të fundit ishte ai i krijuar në Stamboll. Për këtë arsye, shoqëria më aktive dhe e mirënjohur "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njëzuar. Një alfabet i njëzuar do të ishte fillimi i letërsisë mbarëshqiptare. Në këtë kongres ishin të pranishëm 150 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Mithat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: Liria dhe Dituria. Sekretare e komisionit u



ara nga shumica popullsi shqiptare, u pushtuan nga sllavët. Të gjitha dyqanet dhe librat shqip u dogjën dhe shumica e atdhetarëve shqiptar u thirrën nga serbët, disa u burgosën. Popullata myslimane shqiptare u detyrua të braktiste qytetin e Shkupit dhe të Manastirit, ato familje ortodoksë shqiptare që mbetën aty, me kalimin e viteve dhe me dhunë u nënshtruan duke humbur dinjitetin e tyre shqiptar.

**ARDITA BALLAZHI**

# KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

**Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe** u hap në Tiranë më 20 nëntor të vitit 1972. Aty morën pjesë 87 delegatë nga Shqipëria dhe nga shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, si dhe nga arbëreshët e Italisë. Qëllimi i Kongresit ishte të përcaktonte parimet dhe drejtimit kryesore të hartimit të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar.

Zhvillimi i hovshëm e cilësor i kulturës, i letërsisë dhe i shkencës mbi bazën e shndërrimeve të thella historike ekonomiko-shoqërore që janë kryer në Shqipërinë socialiste e që kanë sjellë ndryshime të thella edhe në vetëdijen gjuhësore të popullit tonë, i ka dhënë një shtysë të fuqishme e të pandërprerë njësimimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe, themelet e së cilës janë hedhur që në kohën e Rilindjes.

Masat e gjera popullore, në kundërshtim me



Delegatë të Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

pikëpamjet e ngushta lokaliste, kanë luftuar për një gjuhë letrare të njësuar dhe kanë përkrahur me dashuri çdo përpjekje që i ka shërbyer këtij qëllimi. Duke përmbushur gjithnjë më mirë kërkesat e shumanshme të të gjitha fushave të veprimtarisë shoqërore, gjuha letrare shqipe ka arritur një shkallë të tillë zhvillimi, që na lejon të pohojmë shkencërisht se populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar, norma kombëtare e së cilës është kristalizuar në të gjitha hallkat kryesore të strukturës



fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore e në disa hallka të veçanta ndodhet në fazën e fundit të kristalizimit. Kjo gjuhë letrare përdoret sot pothuajse nga të gjithë shqiptarët brenda e jashtë Republikës Popullore të Shqipërisë dhe është bërë modeli i normës gjuhësore

të përbashkët për të gjithë ata që shkruajnë shqip. Ky Kongres, si forumi më i lartë shkencor, analizoi e diskutoi gjerësisht parimet themelore, çështjet e përgjithshme dhe shumë zgjidhje të veçanta të drejtshkrimit të shqipes, si edhe probleme të tjera teorike e praktike, që kanë të bëjnë me normën letrare në përgjithësi. Drejtshkrimi nuk është vetëm një çështje shkencore, por edhe një problem i rëndësishëm shoqëror, sepse është shprehje e drejtpërdrejtë e njësimimit të gjuhës letrare kombëtare, e cila luan një rol të dorës së parë në forcimin e vetëdijes kombëtare, në zhvillimin e jetës mendore. Kongresi porositi që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si edhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, Rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura. Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shkencës dhe të kulturës, gjithë inteligjencën dhe të gjitha masat punonjëse, që me veprimtarinë e tyre krijuese ta zhvillojnë, ta pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare.

**EDUARTA ZENKU**

# ARBËRESHËT E ITALISË

**Arbëreshët** janë shqiptarë të cilët jetojnë në Itali në jugore që nga shekulli XV dhe XVI. Këta shqiptarë, quajtur arbëreshë sepse ata lanë Shqipërinë që quhej atëherë *Arbëria*, u vendosën në Itali në pesëmbëdhjetë dhe shekullin e tetëmbëdhjetë, pas vdekjes së heroit kombëtar shqiptarë Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe pushtimit gradual të Shqipërisë dhe të gjithë të Perandorisë Bizantine nga turqit osmane. Njihen shtatë eksode të mëdha që nisin që nga koha për një herë pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, deri nga fundi i shek. XVIII (1780-1790), janë ngulimet e fundit të shqiptarëve në Italinë Veriore, si provincën e Pavis dhe të Piacencës, po ashtu një grup i madh i'u drejtua krahinës qendrorë në Molise dhe një tjetër grup në drejtim të krahinës jugore Bazilikatës.



Arbëreshët në Itali, sot numërohen mbi 100.000 njerëz që flasin gjuhën arbërore. Qytetet ku banojnë arbëreshët mbajnë nga dy emra, një në arbërisht, dhe tjetrin italisht.

Një nga veçoritë që karakterizon këtë popull, është që përveç gjuhës dhe traditave, ruajtën me heroizëm edhe ritin dhe preardhjen fetare, ku edhe sot e kësaj ditë e arbëreshëve vazhdojnë në ritin bizantin. Gjatë shekujve arbëreshë kanë arritur të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre, në sajë të kokëfortësinë e tyre dhe vlera kulturore të ushtrohet kryesisht nga të dy komuniteteve fetare të Kisha Katolike Bizantine, bazuar në Kalabri, "Kolegji Corsini" (1732) dhe

pastaj "Corsini-Sant'Adriano" i San Benedetto Ullano në 1794 dhe në Sicili "Seminary grek- arbëresh e Palermos" (1735), pastaj transferohen në Piana degli Albanesi në 1945. Shumica e komunitetet arbëreshë pesëdhjetë ende ruajnë fejen krështere greke-bizantine. Ata i përkasin të dy dioqezat: në Lungro për Arbëreshët e Italisë jugore, dhe Piana degli Albanesi për Arbëreshët e Sicilisë. Për të përcaktuar të tyre "komb" përdorim fjalën *Arbëria*. Sot, deri 1990, janë shumë shqiptarë që arritën në fshatrave arbëreshëve, pikërisht të Piana degli Albanesi në Sicili.

## Arbëreshë të njohur




**Lekë Matrënga (1567 - 1619)**, prift i ritit bizantin, shkrimtar i cili i dha zyrtar të fillojë letërsisë arbëreshe.



**HEROLINDA BALLAZHI**

## JERONIM DE RADA



**Jeronim De Rada** (Girolamo de Rada), lindi në vitin 1814 dhe vdiq në vitin 1903, ishte poet, publicist, folklorist, filolog dhe mësues, themeluesi i letërsisë dhe i kulturës arbëreshe. U lind në Makia të Kalabrisë mësimet e para i kreu në kolegjin e Shën Adrianit të Shën Mitër Koronës. Më 1834 shkoi për të studiuar drejtësi në Napoli, ku mori pjesë gjallërisht në lëvizjen politike dhe kulturore të kohës. Më 1848 nxori të parën gazetë shqiptare "L'Albanese d'Italia", në të cilën shprehu pikëpamjet e tij për ngjarjet e kohës. Pas dështimit të revolucionit më 1848 e mbylli gazetën dhe i zhgënjyer u tërhoq në fshatin e tij të lindjes deri në fillim të viteve 60 të shek. XIX. Duke nisur nga v. 1861, në jetën e De Rada nisi një fazë e re, kur ai shfaqet si një nga figurat më në zë të Rilindjes sonë Kombëtare. Pas traktatit Parimet e estetikës (Principii di estetica, 1861) botoi veprat lashtësia e kombit shqiptar ("Antichità della nazione albanese", 1864) dhe Rapsodi të një poeme arbëreshe ("Rapsodie d'un poema albanese", 1866), që luajtën një rol të rëndësishëm për propagandimin e çështjes kombëtare shqiptare. Hyri në korrespondencë me patriotët shqiptarë dhe me personalitetet kulturore evropiane, dashamirë të Shqipërisë, ndoqi me interes të gjallë ngjarjet në Shqipëri. Më 1878 përkrahu Lidhjen Shqiptare

të Prizrenit dhe ngriti zërin kundër gjymtimit tokësor të Shqipërisë. Një ndihmesë të çmuar çështjes kombëtare i dha me revistën "Flamuri Arbrit", që botoi në vitet 1883-1885. Në "Testamentin politik" (1902) shprehu optimizmin në të ardhmen e Shqipërisë dhe pakënaqësinë e tij ndaj politikës imperialiste të Italisë ndaj atdheut të të parëve.

Zhvilloi një veprimtari të frytshme edhe në fushën e studimeve gjuhësore ; u kushtoi ve mendje çështjeve të prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, duke mbrojtur lashtësinë e tyre. De Rada është nga të parët studiues vendës të strukturës gramatikore të shqipes. Në të dy veprat gramatikore që hartoi (1870, 1894) vuri në dukje aspekte të patheksuara më parë nga dijetarë shqiptarë dhe albanologë dhe dukuri gjuhësore të pastudiuara ose të panjohura. Në veprat e tij gjuhësore jepen të dhëna me interes për të folmet arbëreshe. Bëri përpjekje të vijueshme për një alfabet të përbashkët të shqipes që të jepte një sistem sa më të plotë dhe të përshtatshëm për shqipen me karaktere latine, të plotësuar me shenja diakritike. Në veprimtarinë gjuhësore të De Rada duhet përmendur edhe organizimi i dy kongreseve gjuhësore të shqipes, i pari (1895) në Koriliano Kalabro, i dyti (1897) në Lungro (Kongreset gjuhësore arbëreshe). Dha me vetmohim mësimin e shqipes në Kolegjin arbëresh të Shën Mitër Koronës për dhjetëvjeçarë të tërë gjersa vdiq.

### Tituj të veprave

**Milosao**

**Një pasqyrë e jetës njerëzore**

**Serafina Topia**

**Skënderbeu i pafan** <sup>[1]</sup>

**Fjamuri i Arbërit** (revistë) etj.

**KADISHE IBRAHIMI**

# ISMAIL KADARE



**Ismail Kadare** është një shkrimtar bashkëkohor, disa herë i nominuar për çmimin "Nobel" për letërsi. Dallohet për novela, romane, por ka shkruar dhe poezi dhe kritika. Ai e ka ndarë jetën e tij

mes Francës dhe Shqipërisë. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri dhe veprat e tij janë përkthyer në mbi tridhjetë gjuhë. Gjithashtu është martuar me shkrimaren e njohur te skicave dhe tregimeve për femije, Helena Kadare. Ismail Kadare lindi më 28 janar 1936 në Gjirokastrë, ku përfundoi edhe arsimin e mesëm; më 1958 mbaroi degën e Gjuhës e të Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas shkoi në Moskë me studime për dy vjet në Institutin e Letërsisë Botërore "Maksim Gorki" (1958-1960). Ismail Kadare është një nga shkrimtarët më të mëdhenjë të letërsisë shqipe dhe gjithashtu një nga shkrimtarët më të mëdhenjë të letërsisë botërore bashkëkohore. Me veprën e tij, që ka shënuar një numër rekord të përkthimeve (në mbi 45 gjuhë të huaja) ai e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.

Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gjimnazit Frymëzimet djaloshare, 1954, "Ëndërrimet", 1957), por u bë i njohur sidomos me vëllimin Shekulli im (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: Përse mendohen këto male (1964), Motive me diell (1968) dhe Koha (1976). Vepra poetike e Ismail Kadaresë shquhet për idetë e thella dhe për figuracionin e pasur e origjinal; rol me rëndësi për pasurimin e poezisë shqiptare.

Në vjeshtën e viti 1990 Ismail Kadare vendosi të largohet nga Shqipëria dhe të qëndrojë në Paris.

Shkrimtari në atë kohë e përlegji këtë largim me "mungesën e ndryshimeve demokratike".

Autoritetet e kohës e dënuan largimin e Ismail Kadaresë, por krijimtaria e tij nuk u ndalua. Në vitin 1990 e më pas vepra e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe artistike të shqipes letrare. Letërsia e Ismail Kadaresë pas vitit 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike dhe shpërfaqjen e identitetit shqiptar.

Në 2009 ai u nderua me Diplomë Nderi i Shkencave Sociale dhe Komunikimit institucional ndërsa Universitetit të Palermos në Sicili, kërkuar me forcë dhe dëshirë nga arbëreshëvet të Piana degli Albanesi.

## Disa tituj të veprave të tij

**Frymëzime djaloshare** - poezi 1954

**Ëndërrime** - poezi 1957

**Shekulli im** - poezi 1961

**Gjenerali i ushtrisë së vdekur** - roman - 1963

**Kështjella** - roman - 1970

**Kronikë në gur** - roman - 1971

**Ura me tri harqe** - 1978

**Kush e solli Doruntinën** - roman - 1979

**Koncert në fund të dimrit** - 1988

**Pallati i ëndrrave** - 1996

**Spiritus** - roman - 1996

**Vajza e Agamemnonit** - 2000

**Bisedë përmes hekurash** - 2000

**Princesha Argjiro** - lektyrë - 2003

**Hamleti, princi i vështirë** - Sprovë - 2006

**Spiritus** - 2007

**E penguara** - roman - 2009

**Aksidenti** - roman - 2010

**Ditë kafenesh** - novelë

**BLERINA ZENDELI**

# FOLJA

**Folja** është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që shënon një veprim apo gjendje.

Në gjuhën shqipe ajo ka kategori gramatikore të mënyrës, kohës, vetës, numrit dhe diatezës.

**Folje** quhen fjalët që tregojnë se subjekti vepron ose pëson diçka ose ndodhet në një gjendje të caktuar.

Kur themi motra, macja, e kuptojmë se është fjala për njerëz, kafshë dhe sende, po nuk dimë se çfarë bëjnë ose çfarë ndodh me ta. Por kur themi motra punon, mollët u poqën, macja fle atëherë prej fjalës punon mësojmë se motra po kryen një veprim (punon), prej fjalës u poqën mësojmë se mollët pësuan diçka (u poqën), prej fjalës fle mësojmë se macja ndodhet në një gjendje të caktuar (fle). Fjalët punon, u poqën, fle janë folje.

## Foljet kalimtare dhe jokalistare

Kalimtare quhen foljet veprimi i të cilave i kalon një personi ose sendi tjetër, d.m.th. që pranojnë një kundrinor: -Beni çdo ditë lexon gazetën.

Folje jokalistare janë ato që nuk pranojnë kundrinor: fle, eci, rri, qëndroj, dal etj.:

-Agroni ecte i shqetësuar.

## Format veprorë dhe joveprorë

Foljet kalimtare të drejta kanë dy forma, formën veprorë dhe formën joveprorë:

Forma veprorë: laj, fshij, thaj Forma joveprorë: lahem, fshihem, thahem etj.

Veprorë (laj, fshij, thaj) janë foljet që tregojnë se subjekti vepron (laj fytyrën, fshij dhomën, thaj rrobat).

Joveprorë foljet që tregojnë se subjekti pëson, d.m.th. i nënshtrohet veprimit të një tjetri (lahem nga dikush) ose tregon se subjekti vepron dhe veprimi i tij kthehet po tek ai ( lahem = laj vetveten).

## Kohët e foljeve

Kohët themelore të foljes janë e *tashmja*, e *shkuara*, e *ardhmja*.

E tashmja tregon diçka që bëhet tani.

-Fryn erë dhe bie shi.

E shkuara ka pesë nëndarje: e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera që shprehin veprime të kryera para çastit kur flasim dhe më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar që shprehin veprime para një çasti të caktuar të së shkuarës:

Frynte erë dhe binte shi. Kishte fryrë erë dhe kishte rënë shi.

E ardhmja ka dy kohë të ardhmen dhe të ardhmen e përparme. E ardhmja shpreh një veprim që pritët të kryhet pas çastit kur flasim ose që do të kryhet në të ardhmen: Do të bjerë shi. E ardhmja e përparme shpreh një veprim që pritët të kryhet para një veprimi tjetër në të ardhmen: Kur do të ktheheni ju, unë do t'i kem mbaruar detyrat.

Kohët e foljeve janë: të thjeshta dhe të përbëra. Të thjeshta janë e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e ardhmja. Ato formohen kryesisht me mbaresa që i shtohen foljes: mëso-j, mëso-n, mëso-j-a, mëso-je, mëso-v-a, mëso-v-e .

Kohët e përbëra janë: e kryera ( kam mësuar ), më se e kryera ( kisha mësuar ), e kryera e tejshkuar ( pata mësuar ), e ardhmja e përparme ( do të kem mësuar ). Këto formohen me ndihmën e foljeve ndihmëse.

## Mënyrat e Foljeve

Kuptimi i asaj që shprehet nga folja mund të paraqitet prej folësit në mënyra të ndryshme:

-si diçka e realizuar : Ne punuam.

- si diçka e dëshirueshme: E punofsh gezuar kompjuterin e ri!

- si urdhër: Punoni!

- si habi: Punuakan!

Trajtat e ndryshme që merr folja për të shprehur pikërisht këta kuptime quhen mënyra. Në gjuhën shqipe folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore.

Mënyra dëftore e paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka të vërtetë ose reale, qoftë ky

pohim, mohim ose pyetje:

-Iliri po mëson.

Mënyra lidhore paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçkaqë dëshirojmë ose presim të ndodhë:

-Po të punosh do të fitosh.

Mënyra kushtore e paraqet kuptimin e shprehur të foljes si diçka të mundshme që varet (kushtëzohet) nga një veprim tjetër:

-Po të punoje më shumë, do ta mësoje më mirë kompjuterin.

Mënyra habitore paraqet kuptimin e shprehur prej foljes si diçka të papritur që shkakton habi:

-Sa qenka rritur!

Mënyra dëshirore paraqet kuptimin e shprehur prej foljes në formë urimi ose mallkimi:

-Shkofsh e ardhsh shëndosh!

Mënyra urdhërore paraqet kuptimin e shprehur prej foljes në formë urdhëri, kërkesë, këshillë:

-Punoni më mirë.

Dëftorja, lidhorja, kushtorja, habitorja, dëshirorja dhe urdhërorja kanë forma të veçanta për kohë dhe për veta të ndryshme të çdo numri.

Veç këtyre mënyrave ka edhe forma foljore të pashtjelluara të cilat nuk kanë as kohë as vetë as numër.

Format e pashtjelluara të foljeve janë: pjesorja, paskajorja, përcjellorja dhe mohorja: - pjesorja: punuar, mësuar, blerë, gjetur, tharë etj.;

Foljet kanë edhe një pjesore të shkurtuar e cila gjendet duke i hequr pjesores prapashtesën -r, -rë, -ur, -ë.; punua(r) - punua, bler(ë)- ble(rë), gjet(ur) - gjet thën(ë) - thën.

- paskajorja: për të punuar, për të mësuar, për të marrë etj.;

-përcjellorja: duke punuar, duke mësuar, duke marrë etj.;

- mohorja: pa punuar, pa mësuar, pa mësuar, pa marrë etj.

Në këto trajta, ajo që shprehet nga folja nuk mund të paraqitet prej folësit në mënyra të ndryshme, prandaj ato nuk merren si mënyra.

### **Vetat dhe numrat e foljeve**

Vetë e foljes quhet forma foljore që tregon se kush e kryen veprimin e caktuar.

Numër i foljes quhet forma foljore që tregon se veprimi kryhet nga një ose më shumë qenie apo sende. Folja ka dy numra, njëjës dhe shumësin:

Veta I njëjës: unë punoj;

Veta II njëjës ti punon;

Veta III njëjës ai punon.

Veta I shumës: ne punojmë;

Veta II shumës: ju punoni;

Veta III shumës: ato punojnë.

# ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET

Gjuha shqipe ka 36 fonema (tinguj), ato ndahen në zanore dhe bashtingllore. Zanoret e gjuhës shqipe janë 7 dhe ato janë: a, e, ë, i, u, y, o, kurse bashtinglloret e gjuhës shqipe janë 29.

Shqipja letrare ka vetëm zanore gojore. Nuk ka a hundore dhe nuk dallohen në të shkruar zanore të gjata ose të shkurtra. Fonema **ë** e shqipes letrare i përgjigjet tingullit **ë** t ëtoskërishtes {është, zë, nëna, mëzi} dhe zanores **a** hundore të gegërishtes (asht, za, nana, mazi).

Shumica e bashkëtingëlloreve janë shkronja latine të thjeshta, ose dyshe (bigrame) të përshtatura për disa fonema të shqipes që mungojnë në gjuhët neolatine.

Gjuha shqipe ka si parim themelor të drejtshkrimit parimin fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen ashtu si shqiptohen dhe anasjelltas. Ky parim zbatohet në pjesën më të madhe të fjalëve, si edhe emrat e përveçëm të njerzëve e të vendeve, qofshin shqiptarë, qofshin të huaj. e vetmja zanore që shkruhet edhe në disa raste ku, në fakt, nuk shqiptohet është **ë** fundore, si : *punë, pjesë, fjalë, shkollë, shkallë, rrugë, kam dalë, kam vjelë, kam sjellë, kam mbjellë,*, si dhe në disa pozicione në gji të fjalës: *pjesëmarrës, arkëtar, këmbëshpejtë, argëtim, anëtarësi, mirësi* etj.

Mbi këtë bazë shkruhet sipas

shqiptimit që kanë, në gjuhën prej nga merren, edhe fjalët e huazuara nga gjuhët tjera, si edhe emrat e vendeve e të njerzëve, si: *Diana, Ilada, Beriloz, Diogjen, Etiopi, Hesiodi, Violetë, Jemen, Jalta, Jerusalem, Jordani, Azerbaixhan, Bajron, Bajkal* etj.

Në gjuhën shqipe të shkruar nuk përdoret asnjë lloj theksi. Si rregull, shumica e fjalëve të shqipes e kanë theksin në rrokjen e parafundit (paroksitone): *arë, urë, erë, orë, dorë, derë, darë, punë, fjalë, shkollë, shkallë, hënë, nënë* etj.

Një numër fjalësh janë me theks fundor (oksitone), por ato janë të pakta dhe theksimi i tyre fundor del nga konteksti, pa qenë nevoja për ndonjë shenjë të veçantë: *fe, rrufe, be, shtëpi, çati, parti, rini, liri, lmturi, bukuri, dashuri, dituri, egërsi, trimëri*, si dhe disa fjalë me origjinë nga turqishtja, si: *baba, kala, hata, bela, bakllava, penxhere, tenxhere, xhami, minare* etj.

Ka edhe sasi fjalësh me theksin në rrokjen e dytë para fundit (proparoksitone), si: *flutura, petulla, vetulla, shpatulla, kumbulla, vjedhurazi, fshehurazi, rishtazi*.

Një numër i kufizuar fjalësh kanë formë fonetike të njëjtë (identike) dhe dallohen vetëm nga theksi. Në këto raste, për të mos shkaktuar keqkuptime, mund të përdoret edhe shenja e theksit, si p.sh.: *bári* dhe *barí*, *drejtóri* dhe *drejtorí*, *minístri*

dhe *ministrí*, *stóli* dhe *stolí*, *kállli* dhe *kallí*.

Përveç zanoreve dhe bashtinglloreve në gjuhën shqipe kemi edhe grupe të zanoreve dhe bashtinglloreve, grupet e zanoreve në gjuhën shqipe janë:

ua: muaj, duar, dragua, grua etj;

ye: lyej, ngjyey, pyes, arsye etj;

ue: mësues, ndëgjues etj;

ie: diell, miell, qiell etj.

Kurse bashtinglloret në gjuhën shqipe ndahen në të zëshme dhe të pa zëshme:

-të zëshme: b, d, g, gj, dh, v, z, zh, x, xh etj.


Bashtinglloret formojnë grupet e tyre sic janë:

mb: mbaj, mbes, mbjell, etj

nd: ndaj, ndej, ndërmarrye, etj

ng: ngacmoj, ngarkesë, ngel, etj.

# KULTURA



Kultura është gjithëçka, që nuk ta ka dhënë natyra por duhet krijuar vet. Kultura përfshin besimin tone, sjelljen, mënyrën sesi e konceptojmë rrethin dhe këndvështimin

tone. Pjesët më të mëdha të kulturës trashigohen më tej nëpërmjet familjes ose bashkësis. Gjatë rritjes, njerëzit pa e kuptuar i pranojnë këto dituri, vlerat dhe zakonet të grupës së tyre shoqërore ju duken normale, ndërsa zakonet e grupeve të tjera ju duken të huaja madje edhe kërcënuese. Megjithatë disa njerëz vendosin ti pranojnë ose ti largojnë disa gjëra. Kultura e përbashkët i përforcon lidhjet në shoqëri. Prej saj individët i ruajnë rregullat e përgjithshme të sjelljes, të cilat vet nuk do të mund ti zhvillonin deri në fund të jetës së tyre.

Secila kulturë bazohet në tre elemente: kuptimet, zakonet dhe objektet. Me gërshetimin e këtyre elementëve zhvillohet këndvështrimi dhe caktohet vendi i individit në botë. Kuptimet e përbashkëta janë bazat e një kulture. Njerëzit më lehtë kuptohen nëse kanë vështirim të njejtë për botën, kritere të ngjajshme me të cilat dallojnë të mirën nga e keqja, madje edhe kritere estetike në kuptimin e idealeve të përbashkëta për bukurinë. Vështirimet e botës të ndonjë bashkësie reflektohet në zakonet e veta. Disa zakone formohen për shkaqe praktike, si mbrojtja e shëndetit dhe siguria. Në to përfshihen rregullat që mund të ushqehen, çfar të veshet në kushte të vështira në ambientin jetësor, si dhe prirjet higjienike. Zakone të caktuara janë të vendosura

ashtu që të sigurojnë veprime të drejta në mes njerëzve. Të tjerat munden tu japin mundësi individuale dhe grupit ta vërtetojnë identitetin e tyre posaçërisht para njerëzve të panjohur. Kulturën e rregullojnë edhe objektet të cilat i përdorin njerëzit. Shumë objekte të tilla kanë vlerë simbolike dhe praktike: për shembull, ndonjë alat pune si stetoskopi ose mantili i bardh i mjekut, mund të jenë sibole të statusit, por edhe mjetet e domosdoshme për punë. Disa objekte që i kanë njerëzit, si tupani tek shamanët, kanë qëllim ritual. Të tjerat si bizhuterit ose veprat e artit kanë qëllim dekorativ ose e tregojnë pasurinë, statusin ose shijen e pronarit.

Njerëzit e paraqesin kulturën nëpërmjet besimeve të tyre, mënyrën e komunikimit, veshjen dhe zbukurimin e trupit por edhe nëpërmjet artit dhe shkencës. Religjionet dhe sistemet e tjera të besimit japin zgjidhje prej udhëzimeve për jetën, japin sqarime për formimin e univerzitetit, prejardhjen e njeriut dhe çfarë ndodh pas vdekjes. Këto gjithashtu njerëzve u japin mundësi ti caktojnë etapat e jetës, si që është lindja, moshën e pjekurisë, martesën dhe vdekjen. Kultura është gjeja kryesore e njeriut dhe ne qoftë se ke kulturë gjithëçka.



**ARDIAN BAJRAMI**

## KY QYTET I BUKUR FLET SHUMË POR NJERËZIT E TIJ JANË MEMECË!



Një pamje e bukur me një shkëlqim rrezatues, rrezaton në shpirtrat e njerëzve duke u ngjall atyre një ndjesi të mrekullueshme, duke i bërë të ndihen se rrugëtojnë me hapa të sigurt mbrenda horizontit të jetës dhe këtë pamje të mrekullueshme ta mbajnë si një panoramë të këtij qyteti.

Është qyteti ai që flet shumë, që dhuron shumë, që fali shumë për këta njerëz, ju fali gjithë shkëlqimin e rreaztimin e tij, ju dhuroi ngrohtësi e ndricim në zemrat e tyre por i luti ata vetëm një gjë që ata kurrë nuk arritën ta plotesojnë, kurrë nuk ishin të denjë për të, e nuk iu përgjigjën lutjes së tij nuk e mbrojtën me ndershmëri e krenari, por ia kthyen shpinën dhe e lanë të vetmuar, e lanë ta shfrytezoj dikush tjetër. E braktisën, e lanë të vetmuar, ia kthyen shpinën si për të mos dashur tu përgjigjen bukurive joshëse që ua fali ky qytet.

Edhe pse u fali një kurorë të artë të stolitur bukur, edhe pse ata kërkuan lirinë si gjë më të shtrejtë edhe atë ua fali ky qytet i mrekullueshëm, e ata u treguan mosmirnjohës, nuk e mbrojtën atë dhe morrën rrugën e pashmangshme e shkuan në mërgimin e mallkuar, që kjo rrugë ishte e pakthyeshme e për këtë qytet ishte plaga më e rënde që e kishte marrë ky qytet ndonjëherë. Ishin këto njrrzëit memec që nuk ditën të folnin kur fjala e tyre kishte vlerë, nuk i vlerësuan shpërblimet që ua fali ky qytet. Fol, mos hesht vepro e puno që me armën më të fortë të më mbrosh mua, merrni lapsat e luftoni armikun, mbroni qytetin tuaj se pa fjalët tuaja nuk kam forcë që të mbijetoj, pa punën, kurajon dhe vullnetin tuaj unë nuk mund të ruaj këtë bukuri të fshehur në oazat e dëshirave tuaja, më ndihmoni e më mbroni se jeni ju ata që mund të më mbroni. Ishin këto fjalët e qytetit që u lutej njerezve të tij por ato pothuajse ishin te shurdhur e nuk dëgjonin këto fjalë e ishin memec e nuk folnin për të mbrojtur këtë qytet.

E kuptuan këtë e donin të kthejnë kohën mbrapa për të folur, për të ngritur zërin, për të mbrojtur qytetin e tyre por ishte tepër vonë, mërgimi kishte gëlltitur forcën e tyre, ua kishte vjedhur vullnetin e kurajon dhe kishte shkrirë kockat e tyre duke i bartur në lumin e mallkuar.

Kur këto njerëz filluan të flasin dhe të vlersojnë bukuritë e këtij qyteti, kur e kuptuan se dielli me bukur rrezatonte në këtë qytet, yjet më shumë shkëlqenin, por edhe perëndimi i diellit ishte i bukur në vendin e tyre, ishte vonë se tanimë qyteti nuk i dëgjonte, ngase ata e kishin braktisur kur ai u jepte gjithcka!

Bukuria, shkëlqimi dhe ndricimi i qytetit mbetën në sirtarët e humnerës vetëm për atë që njerezit nuk hapuruan në rrugën e shejntë por vazhduan rrugën e mallkuar dhe braktisën qytetin e tyre.

**BLERANDA LUTFIJU**

# LIQENI I OHRIT-REPORTAZH



Liqeni i Ohrit është pasuria më e madhe që natyra u ka falur njerëzve të kësaj ane. Liqeni nga më të bukurit në botë është krenaria e tyre ,por edhe burim i të ardhurave materiale për një pjesë të mire të qytetarëve. Krahas bukurisë së rrrallë, florës dhe faunës së pasur, këtë liqe e karakterizojnë edhe disa fshehtësi që janë komentuar dhe komentohen nga adhuruesit e tij.

Të shumta janë gojëdhënatdhe legjendat që lidhen me liqenin e vjetër dhe të bukur. Ato flasin për lidhjen e ngushtë dhe dashurinë që kanë njerëzit e kësaj ane për këtë perlë të natyr]s. Por sipas tyre edhe liqeni mban qëndrimin e duhur ndaj këtyre njerëzve. Dhe ky pretendim mbështetet mbi legjendatqë të cilat janë përcjellur dhe janë trashëguar deri në ditët e sotme.

Legjenda thotë se Skënderbeu ishte i lodhur nga lufta me ushtrit osmane the kishte vendosur që të shkonte e të pushonte bashkë me ushtrinë e tij në Liqenin e Ohrit. Aty nuk e linin të qetë bretkosat dhe i mallkoi. Thonë se pas këtij mallkimi aty me nuk kanë ekzistuar bretkosa.

E njohur është edhe legjenda me dy vllazërit në gjirin e Naumit.


Njëri prej tyre ka pasur shumë dele e tjetri një kec. Një natë ata janë grindur midis veti për kullosat. Vëllai i deleve është kacafytur me atë të kecit duke i thënë se për shkak të kecit të tij delet nuk kanë për të kullotur. Dy vëllezërit janë zënë keq saqë janë përgjakur.

Sipas gojëdhënës për shkak të kësaj ngjarje "një mjegull e madhe është ngritur nga mali Galicicë në drejtim të liqenit dhe kanë fryrë erëra të forta,ndërsa dëshmitar i kësaj rrëmuje të krijuar është Shkëmbi i Kuq, në të cilin edhe sot shihen gjurmë të kuqe dhe të bardha nga qumështi i derdhur dhe gjaku i vëllezërve".

Liqeni i Ohrit është i pasur me specie të ndryshme të botës bimore dhe shtazore. Edhe pse po bëhen përpjekje për ta ruajtur florën dhe faunën e këtij liqeni shumë specie të tij rrezikojnë të zhduken. Në radhë të parë kjo ndodh për shkak të ndotjes së Liqenit, si dhe për faktin tjetër që në të peshkohet në mënyrë të pakontrolluar.

**HEROLINDA BALLAZHI**

# KALAJA E KRUJËS-REPORTAZH



500 vjet më parë, Kalaja e Krujës u pushtua nga turqit, 500 vjet më pas, porta e saj u “pushtua” nga tregtarët vendas. Janë një numër i madh tregtarësh, të cilët vitet e fundit kanë zgjedhur portën hyrëse të kalasë për të tregtuar mallrat e tyre. Të shtyrë nga numri i madh i turistëve që vizitojnë këtë kala, krutanët e kanë parë si mënyrë fitimi tregtinë në rrugicat e saj. Aty mund të gjesh shumëllojshmëri produktesh, kryesisht souvenire dhe prodhime artizanale. Rruga që të çon në qytetin e vogël turistik, është e mbushur nga të dyja anët me pemë të llojeve të ndryshme, ndërsa në brendësi të qytetit rrugicat janë të shtruara me kalldrëm.

Në faqen e malit shtrihet madhërisht qyteti i Krujës, i cili është një ndër qytetet më të vjetër dhe më të njohur të Shqipërisë

Numrin më të madh të vizitorëve që “pushtojnë” kalanë e Krujës, sigurisht, kësaj radhe me dëshirë, janë qytetarët e ardhur nga Kosova dhe nga shtete të huaja. Kureshtarë, njëkohësisht edhe të mirëinformuar sa i përket historisë së heroit tonë legjendarë “Skënderbeut”, ata shohin me vëmendje çdo detaj që përbën kalanë, sikur duan të vërtetojnë apo ta lidhin atë me historinë. Ndër suveniret më të preferuara mbeten pjatat porcelani të murit ku është skalitur kalaja, ose “Skënderbeu”. Po kështu edhe suveniret e tjera si p.sh një qilim i punuar me mjeshtëri artizanale, një mbulesë tavoline me punim grepi, apo në rastet kur e ‘adhurojnë’ Shqipërinë, një flamur a një veshje jona kombëtare nuk përbën asnjë problem për ta. Megjithatë, ndonëse më të pakët në numër, në qytetin historik nuk mungojnë as vizitorët të cilët vijnë nga rrethet e tjera të Shqipërisë, enkas për t’i treguar pasardhësve të tyre, një pjesë të historisë, që u shkrua me gjak.

Kalaja e Krujës është një nga kalatë më të njohura në Shqipëri. Kjo kala me trajtë eliptike dhe me perimetër 804 m, zë një sipërfaqe prej 2.5 ha tokë dhe është ngritur në një kodër shkëmbore. Gërmimet arkeologjike të vitit 1978 dëshmojnë se kodra ka qenë e banuar që në shek e III p.e.r. ndërsa kalaja është ngritur në shek. V-VI e.r. Pranë saj është zbuluar një varrezë e madhe e kulturës arbërore. Përmendet me emrin e sotëm në shek e IX bashkë me qytetin e Krujës si qendër peshkopale. Në shek XIII-XIV ishte qendra e shtetit të Arbrit. Gjatë periudhës së Skënderbeut u bë kryfortesa e qëndresës së shqiptarëve kundër pushtimit osman.

**HAVA RRAHMANI**

# LOJA E FATIT



Ishte një natë e ftohtë dimri. Ku çdokush rrinte i mbyllur në shtëpi. Stuhia e madhe e borës ishte si një ferr për të varfërit të cilit jetonin nëpër kasolle...

Në këtë fshat jetonte edhe një fshatar i varfër me familjen e tij: bashkeshortja dhe fëmijët Loni dhe Lira. Ndonëse ishin shumë të vegjël dhe të varfër ato nuk mund të bënin asgjë për familjen e tyre. Në këtë natë të frikëshme fatkeqësisht gruaja e fshatarit ishte shumë e semurë. Fshatari ishte shumë i mërzitur për të por ishte i pafuqishëm për ta ndihmuar sepse ishte e pamundur të dalësh jashtë në këtë natë të ftohtë ku doktori më i afërt gjendej disa kilometra larg, por ai mblodhi forcat dhe vendosi të shkojë të sjellë një doktor. Kaluan rreth tre orë, por asnjë shenjë e doktorit. Fati i keq e përqafoi përsëri fshatarin dhe këtë herë iu desh të përballej me disa ujqër të inatosur të cilët do të vendosnin fatin e tij përgjithmonë. Ujqit filluan sulmin mbi fshatarin, si ferri i vërtetë i vdekjes. Ai bërtiste më sa kishte fuqi, por ishte e kotë sepse askush nuk mund ta ndihmonte. Ai vdiq, por duhet thënë edhe pse ai nuk pati fare fat sepse dhjetë hapa më larg gjendej shtëpia e një doktori i cili kur i dëgjoi të bërtiturat e fshatarit doli jashtë, por ai u cudit sepse aty nuk kishte asgjë dhe u fut brenda. Gjaku i fshatarit ishte mbuluar nga bora e vrullshme. Ndërkohë gruaja e fshatarit filloi të bëhej me mirë ndërsa Loni dhe Lira prisnin kthimin e babait. Gruas së fshatarit tre netë rrjesht iu shfaq një ëndërr. Natën e parë iu shfaq sikur burri i saj ecte në dëborë i vetëm, natën e dytë iu shfaq sikur fshatari përballet me ujq dhe vdes, kurse natën e tretë i shfaqet burri i saj i cili i thotë: “ Unë u largova nga kjo botë pa dëshirën time, por dije që zemra ime do të jetë gjithmonë me ty. Zemra ime pushoi së rrahuri në krahinë ku edhe filloi të rrahë por tani ajo pushon e qetë në botën tjetër.” Pas kësaj ëndërrë gruaja i hapi sytë dhe dy pika loti i rrëshqitën në faqe, i përqafoi Lonin dhe Lirën dhe u tha: “Të dashur fëmijët e mi, babai juaj ka ndërruar jetë rrugës për te doktori, por unë nuk dua që ju të mërziteni sepse një ditë ju do të rriteni dhe do të na bëni krenar mua dhe babain tënd që do t’ju shikojmë nga bota tjetër. Lamtumirë dhe Zoti qoftë me ju.” Gruaja vdiq kurse Loni dhe Lira u birësuan nga një familje e pasur. Ato kishin gjithcka në këtë shtëpi, por ato morrën diçka shumë të rëndësishme nga shtëpia tjetër dhe ai ishte kujtimi i nënës dhe babait i cili do të jetoje PERGJITHMONË në zemrat e tyre...

**SANIE LIMANI**

# THËNIE

Fjalët e mira janë të shkurtëra dhe të lehta të thuhën, por jehona e tyre është e përjetshme...

**|Nënë Tereza|**

Shokët më të mirë të udhëtimit janë librat: ata flasin kur ke nevojë, heshtin kur duhet heshtur. Të bëjnë miqësi pa qenë të bezdisshëm. Japin kaq shumë pa kërkuar asgjë.

**| Tiziano Terzani |**

"Nuk ka shok më besnik sesa një libër."

**|Ernest Hemingway|**


"...Të jesh i mirë është e lehtë, vështirë është të jesh i drejtë..!"

**|Victor Hugo|**

"-Kam dëgjuar shpesh, Sanço, se, t'u bësh mirë të këqijve, është si të hedhësh ujë në det."

**|Miguel de Cervantes|**

## Fjalëkryq



### horizontalet

- 1: "— forcë" që krijohet në raste urgjence  
 6: e arrin ose e —  
 10: Metal që "zbukuron" metalet e tjerë  
 16: Lumë në kufirin e Europës me Azinë  
 21: E rrahu vëndçe ose e rrahu —  
 25: është me majë... tek trupat gjeometrikë  
 29: Film i Çarli Çaplinit  
 43: Sigla e eksplorërit më të njohur  
 47: Nani, rregjist italian.  
 54: Hordhi pa dhi  
 57: Film i Çarli Çaplinit  
 71: Urdhër... për të mos ndenjor në këmbë  
 77: Tolloni i mensës.  
 82: Sigla e forcave ajrore angleze  
 85: Diktatori i irakenëve  
 92: aftësia e të thënit me fjalët e duhura  
 103: masë angleze (2.54cm)  
 108: Fiori  
 114: kur ka më shumë se shumë  
 123: mund të jetë e ftohtë... ose zjarri  
 127: ajo e kreditit është më komode  
 134: Figura që simbolizon

### vertikalet

- 2: Rrethi i artë mbi kokën e shenjtërve  
 3: — Lanka  
 4: Një 'set' në peskatësh  
 7: Aperitiv i njohur italian.  
 8: Komplet kundër luftës  
 11: shkove, u largove, —  
 12: Copë buke e tharë nga të ndenjorit  
 13: Morikone, kompozitori i filmave western  
 19: Përshëndetja e fundit  
 23: metropoli  
 29: ndonjë, ndokush  
 34: Shoku/armiku i xherrit  
 38: Kryeqytet  
 42: mashtrimi (ekonomik)  
 59: është kokërr me thelpinj... që djegin  
 83: ... Galica dhe Hajdari quheshin kështu  
 90: Kështu fillojnë inicialet  
 95: autobus... në shina.  
 105: Centimetër kub... tek shiringat.  
 114: Targa e Tarantos  
 116: Sigla e postës  
 124: Perëndia e diellit për egjyptin e lashtë  
 126: Simboli i arit.